

DATE 05.11.2022

AKTI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

“CONCEPT HOME” SHPK

-Z. Ardian Peca , lindur me **06.12.1998** ne Diber banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, i indentifikua nga pasaporta me nr personal me Nr.**Id J812060760**, me nr.telefoni **068 57 75 015**

Të cilët mbështetur në Ligjin Nr.9901 dt. 14/04/2008, “Për shoqëritë Tregtare” dhe në Legjislacionin shqiptar në përgjithësi, kanë vendosur si më poshtë:

Emërtimi, Selia dhe afati i Shoqërisë

Neni 1

Të themelojë shoqërinë me përgjegjësi tëkufizuar, për të zhvilluar veprimtari private.

Shoqëria është person juridik Shqiptar, Veprimtaria e të cilës rregullohet nga kjo kontratë, Statuti i saj dhe Legjislacioni në fuqi.

Neni2

Shoqëria do të emërtohet **“CONCEPT HOME” SHPK**

Neni 3

Selia e Shoqërisë **“CONCEPT HOME” SHPK**do të jetë: **Rr”Komuna e Parisit “Zona kadastrale 8260 Nr Pasurie 6/330+1-N6,Tirane.**

Neni 4

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj me afat të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet ose të shkurtohet me vendim asamblesë së ortakëve.

Shoqëria **“CONCEPT HOME” SHPK**, gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga moment i regjistrimit si e tillë në regjistrin e QKB-së.

Neni 5

Objekti i aktivitetit të shoqërisë **“CONCEPT HOME” SHPK**



do të jetë:

Ndermjetësimin e Pasurive të paluajtshme, Blerje, shitje, dhenie me qera e pronave, makinave etj. Rikonstruksione objektsh civile. Siguracione makinash dhe mjete motorrike, Siguracione pasurive të paluajtshme etj.

Neni 6

Shoqëria ushton aktivitetin e saj mbi bazë dege në qytete të tjera të vendit, të cilat do të hapen pasi të ketë filluar aktiviteti i shoqërisë.

Neni 7

Selia e shoqërisë mund të transferohet.

Neni 8

Kur shoqëria pushon veprimtarinë e saj, pasi shlyhen të gjitha detyrimet që ka, pjesën e mbetur të kapitalit dhe të të ardhurave i përfitojnë ortakët e saj.

Ortakët themelues përballojnë humbjet e shoqërisë deri në kufirin e vlerës së tij të derdhur në formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund të ritet nga fitimi në natyrë, ose kredi në lekë ose valutë që merret në Bankat e Shtetit Shqiptarë. Kapitali Themeltar për vazhdimin e aktivitetit të shoqërisë është në shumën **4 000 000 Lekë**, që i takon ortakëve themelues.

Ortakët pas zbritjes së taksave do t'i ndahen si vijon:

- Fondi Rezervë
- Shpërblimi që i takon ortakëve themelues në masën 100%.

Neni 9

Shoqëria mund të hyjë në veprimtari të përbashkëta me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja.

Neni 10

Veprimtaria e Shoqërisë mund të ushtrohet duke krijuar filial ose përfaqësi brenda dhe jashtë vendit, në konformitet me Ligjin Shqiptar ose të huaj.

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve **Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore**

Neni 11

- Administrimin e veprimtarisë në përputhje me kontratën dhe statutin.



- Pjesëmarrjen në rezultatet e cdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga mbledhja e përgjithshme e Asamblesë dhe organet e tjera të shoqërisë.
- Të heqë dorë nga shoqëria, heqja dorë nga shoqëria nuk liron ortakët nga detyrimet financiare të marra më parë ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesit të tij ose vetë.
- Të emërojë dhe të shkarkojnë përfaqësuesit e saj, punonjësit, ekspertin kontabël dhe likuidatorët.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Të depozitojnë kuotën e tyre dhe kuotën suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vetë ata.
- Ti japë Shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e cdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ka detyrimin nëse heqin dorë nga shoqëria ti njoftojnë vendimin e tij asamblesë 6 muaj përpara dhe duke ceduar të drejtën e zgjedhjes sipas nenit.
- Ti japi shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

Administrimi

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.

Neni 12

ADMINISTRATORI

Veprimtaria operative e shoqërisë drejtohet nga Administratori i saj i Përgjithshëm. Në Shoqërinë **“CONCEPT HOME” SHPK**

Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z. Ardian Peca**, i cili në të njëjtën kohë ka edhe funksionin e përfaqësimit të shoqërisë me të tretët në të gjithë veprimtarinë e tij. Me miratimin e ortakëve mund të emërohen administrator dhe përfaqësues të shoqërisë **“CONCEPT HOME” SHPK**



Administratori emërohet për një kohëzgjatje prej pesë vjetësh finaciare me përjashtim të rasteve të dorheqjes ose shkarkimit të parakohshëm. Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet me interes të shoqërisë dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh. Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Mbyllja e Shoqërisë:

Neni 13

Veprimtaria e shoqërisë pushon me propozimin e bërë nga ortakët, kur gjatë dy vjetëve nuk rezulton rentable si dhe të gjitha rastet që parashikohen në dokumentet e krijimit të shoqërisë (kontrata). Shoqëria shpërndahet në formë riorganizimi ose likuidimi.

Kur shoqëria likuidohet:

Neni 14

Asambleja e ortakutëve emëron likuidatorin, dhe shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në castin e miratimit të këtij bilanci të likuidimit. Komisioni I Likuidimit përbëhet nganjë ose tre anetarë. Pasuritë që janë venë në dispozicion të shoqërisë me të drejtë shfytëzimi, shiten në vartësi të shkallës së konsumit të tyre. Mjetet finaciare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve të saj dhe fondeve finaciare ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje në përpjestim me kuotat e vëna, pasi të jenë bërë pagesat për kreditorët.

Neni 15

Kur pushon Veprimtaria e një filiali, për efekte të riorganizimit të tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Përgjithsme e ortakut.

Likuidimi i filialeve bëhet njësoj si për shoqërinë. Mjetet finaciare vihen në dispozicion të shoqërisë pasi tu jenë bërë pagesat likuiditorëve.

Dispozita të hollsishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Z.ARDIAN PECA

ARDIAN PECA

